



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___/___/2018

V E N D I M

Nr. 225, Datë 05/11/2018

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 118, datë 09.08.2018, e Znj. A. S., ku pretendohet diskriminim për shkak të “bindjeve politike”¹, nga ana e Q.P.N. Kuçovë.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi²,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, si dhe mbështetur në dokumentacionin bashkëlidhur, rezulton se ankuesja punon në pozicionin e juristes pranë Q.P.N. Kuçovë. Znj. A. S. shprehet se ndaj saj janë dhënë padrejtësisht 2 (dy) masa disiplinore, nga ana e Drejtorit të Q.P.N. Kuçovë. Nëpërmjet shkresës nr. 89, datë 20.09.2017, ankueses i është dhënë masë disiplinore “*vërejtje me shkrim*” dhe nëpërmjet shkresës nr. 101, datë 02.11.2017, i është masa disiplinore “*vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës*”. Sipas informacionit të dërguar nga Znj. A.S., rezulton se këto masa disiplinore aktualisht janë objekt shqyrtimi gjyqësor pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat. Në vijim të dy masave disiplinore, nëpërmjet shkresës

¹ Referuar kartës së anëtarësisë nr. 22870, lëshuar në datën 05.10.2016, nga Lëvizja Socialiste për Integrim, si dhe vërtetimit 08.08.2018, lëshuar nga LSI, Dega Kuçovë.

²Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën KMD.

nr. 6508, datë 24.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., ankuesja është njoftuar mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës në datën 28.09.2018, për shkak të pushimit kolektiv.

Për sa më sipër, ankuesja pretendon se Q.P.N Kuçovë/Albpetrol sh.a. ka filluar procedurat për largimin e saj nga puna, për shkak të bindjeve të saj politike. Për këtë arsye, ajo kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit për shkakun e sipërpërmendur, duke e lidhur fillimin e diskriminimit me dhënien e masave disiplinore në ngarkim të saj, e në vijim me fillimin e procedurave nga Albpetrol sh.a. për largimin e saj nga puna.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

- A.** Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 118, datë 09.08.2018, e Znj. A. S., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33, pika 3 të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.
- B.** Mbështetur në nenin 33, pika 7³, të ligjit nr. 10 221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi iu drejtua Q.P.N. Kuçovë dhe Albpetrol sh.a. dhe për dijeni ankuses, me shkresën nr. 1127/1, datë 13.08.2018, ku kërkohej informacion, lidhur me çështjet e parashtruara nga ankuesja, si dhe iu kërkua të dërgoheshin aktet e poshtëcituarat:
- Informacion mbi autoritetin përkatës, që ka kompetencë të japë masa disiplinore për punonjësit e Q.N.P.-ve, në bazë të Rregullores së Brendshme të Albpetrol sh.a.;
 - Kopje e kontratës së punës së ankuses me Q.P.N. Kuçovë/Albpetrol sh.a.
 - Kopje e librezës së punës së ankuses;
 - Kopje e të gjithë masave disiplinore të dhëna për ankuesen gjatë periudhës, që ka punuar pranë Q.P.N. Kuçovë.
 - Vlerësime për punën e kryer nga ankuesja ndër vite pranë Q.P.N. Kuçovë.

³ Neni 33, pika 7, i ligjit 10 221/2010, parashikon : “Me marrjen e ankesës, komisioneri verifikon faktet. Për këtë qëllim, komisioneri mund t’u kërkojë ankuesit dhe personit kundër të cilit është drejtuar ankesa, të paraqesin parashtrime me shkrim brenda 30 ditëve nga dita që palët marrin njoftimin. Kur e çmon të nevojshme, komisioneri merr informacione dhe nga çdo person ose burim tjetër”.

- Informacion mbi arsyet e zbatimit të pushimit kolektiv nga puna të punonjësve të Q.P.N. Kuçovë/Albpetrol sh.a.
 - Kriteret mbi të cilat është mbështetur Q.P.N. Kuçovë/Albpetrol sh.a., për përzgjedhjen e punonjësve të Q.P.N. Kuçovë, që do t'i nënshtrohen pushimit kolektiv nga puna.
 - Numri i përgjithshëm i punonjësve të Q.P.N. Kuçovë, që do t'i nënshtrohen pushimit kolektiv nga puna.
1. Zarfi me shkresën nr. 1127/1, datë 13.08.2018, e KMD-së drejtuar Q.P.N. Kuçovë u kthye mbrapsht nga shërbimi postar, pasi kjo qendër kishte refuzuar ta merrte në dorëzim.

Në vijim, korespondenca zyrtare e Komisionerit, lidhur me shqyrtimin administrativ të ankesës nr. 118, datë 09.08.2018, së Znj. A. S., u mbajt me Albpetrol sh.a.

2. Në përgjigje të shkresës nr. 1127/1, datë 13.08.2018, së Komisionerit, Administratori i Albpetrol sh.a. dërgoi shkresën nr. 1127/2, datë 06.09.2018⁴, nëpërmjet së cilës e informon Komisionerin se Znj. A. S. është punonjëse e Albpetrol sh.a. prej datës 23.03.2015, në pozicionin e punës “jurist” pranë Qendrës së prodhimit të Naftës Kuçovë.

Gjatë vazhdimësisë së marrëdhënieve të punës me shoqërinë “Albpetrol” sh.a., ndaj Znj. A. S. janë dhënë dy masa disiplinore “*vërejtje me shkrim*” më datë 20.09.2017 dhe “*vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna*”, në datën 02.11.2017, nga titullari i Qendrës së Prodhimit të Naftës Kuçovë. Në të dyja rastet masat disiplinore janë dhënë për shkak të mosrespektimit të orarit të punës. Sipas informacionit të paraqitur nga Albpetrol sh.a., rezulton se nga të dhënat e përcjella nga Qendra e Prodhimit të Naftës Kuçovë, Znj. A. S. nuk ka respektuar orarin e punës në mënyrë të përsëritur pavarësisht paralajmërimeve të shumta verbale nga ana e titullarit të Qendrës. Ndaj masës së parë disiplinore të marrë në datën 20.09.2017, Znj. A. S. ka paraqitur kundërshtimet e saj pranë Administratorit të “Albpetrol” sh.a., me porosinë e së cilit Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Administratës ka zhvilluar takim me Znj. A. S. në datën 11.10.2017. Takimi është pasqyruar në procesverbalin me nr. 6742, datë 11.10.2017, sipas së cilit pasi janë shqyrtuar pretendimet e Znj. A. S. dhe tërësia e provave, janë caktuar disa detyra për t'u zbatuar nga ana e ankueses (ku përshihej edhe respektimi i orarit zyrtar të punës), me të cilat kjo e fundit ka rënë dakord. Në vijim, Znj. A. S. sërisht nuk ka respektuar orarin e punës në datën 01.11.2017 dhe për këtë shkelje në mënyrë të përsëritur, në datën 02.11.2017, ka marrë masën disiplinore “*vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna*”. Referuar dokumentacionit që disponon, Albpetrol sh.a shprehet se masat disiplinore ndaj Znj. A. S. janë marrë në përputhje me kontratën

⁴Shkresa i është dërguar për dijeni edhe ankueses.

individuale të punës për shkak të mosrespektimit të orarit të punës dhe jo për motive të tjera abuzive.

Në vijim, Albpetrol sh.a shprehet se aktualisht ankuesja është në afat njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit të kësaj shoqërie. Në zbatim të programit të Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës të “Albpetrol” sh.a. dhe Vendimit nr. 496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqëria “Albpetrol” sh.a. është në proces ristrukturimi për reduktimin e fuqisë punëtore. Për këtë arsye ka ndërmarrë hapat për nisjen e procedurave të pushimit kolektiv duke njoftuar punonjësit që preken nga ky proces. Në rastin konkret, sipas strukturës së re organizative të miratuar për Qendrën e Prodhimit të Naftës Kuçovë, pozicioni punës “*jurist*” në administratë është shkurtuar dhe Znj. A. S. është njoftuar rregullisht me shkresën nr. 6508, datë 24.07.2018, mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për shkak të shkurtimit të vendit të punës, bazuar në nenet 143 dhe 148 të Kodit të Punës. Kriteret, mbi të cilat është mbështetur Albpetrol sh.a. për të kryer përzgjedhjen e punonjësve të Qendrës së Prodhimit të Naftës Kuçovë që u prekën nga pushimi kolektiv janë: arsimi, kualifikimi profesional/kategoria/patentë/liçencë specifike dhe vjetërsia në punë. Në shkresën nr. 1127/2, datë 06.09.2018, e Albpetrol sh.a., theksohet fakti se në rastin e ankueses A. S., vendi i saj i punës është shkurtuar dhe nuk i është nënshtruar procesit të vlerësimit apo pikëzimit sipas kriterëve të mësipërme, pasi në strukturën e qendrës ekzistonte vetëm një vend pune “*jurist*”.

Albpetrol sh.a. thekson faktin se me kërkesën e Znj. A. S., pranë kësaj shoqërie është ushtruar kontroll nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, Dega Rajonale e Qarkut Berat, në përfundim të së cilit nuk u konstatuan shkelje ligjore.

Njëkohësisht, nëpërmjet shkresës së kësaj shoqërie sillet nën vëmendjen e Komisionerit të veprimet e ndërmarrura ndaj Znj. A. S., si marrja e masave disiplinore, ashtu edhe njoftimi për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, për shkak të ristrukturimit të Albpetrol sh.a., nuk janë të karakterit diskriminues apo që përbëjnë trajtim të diferencuar, por veprime që rrjedhin nga një marrëdhënie reciproke kontraktuale punëdhënës-punëmarrës. Nga procesi i ristrukturimit të “Albpetrol” sh.a janë prekur rreth 450 punonjës, të cilët janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit të shoqërisë, në zbatim të dispozitave përkatëse të Kodit të Punës. Në Qendrën e Prodhimit të Naftës Kuçovë janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, si pasojë e pushimit kolektiv, 27 punonjës të kësaj qendre.

Bashkëlidhur shkresës në fjalë, “Albpetrol” sh.a. përcolli në adresë të Komisionerit dokumentacionin e kërkuar në shkresën nr. 1127/1, datë 13.08.2018, e KMD-së.

3. Në vijim të shkresës nr. 1127/2, datë 06.09.2018, të Albpetrol sh.a., Znj. A. S. dërgoi shkresën nr. 1127/3, datë 24.09.2018, ku thekson faktin se vërejtja me shkrim e dhënë ndaj saj nga Drejtori i Qendrës së Prodhimit të Naftës Kuçovë, në datën 20.09.2017, është e pavlefshme pasi ky i fundit nuk ka kompetenca ligjore për dhënien e masave disiplinore. Drejtori i Qendrës ka patur të drejtën e paraqitjes së propozimit për dhënie masash disiplinore për punonjësit e qendrës, por është Administratori i Shoqërisë autoriteti që ka tagër dhënien e tyre. Njëkohësisht, ankuesja thekson faktin se masa disiplinore e dhënë ndaj saj është parashkruar dhe si e tillë nuk ka më fuqi ligjore. Lidhur me masën e dytë disiplinore ankuesja shprehet se ka qenë tendencioze nga ana e drejtorit të Qendrës.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

Mbështetur në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri vlerëson se:

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Ankuesja A. S., e lindur në Berat, në datën 19.10.1987 dhe banuese në Kuçovë, ka punuar që prej datës 23.03.2015, në pozicionin “jurist” pranë Q.P.N Kuçovë, në varësi të Albpetrol sh.a. Në bazë të dokumentacionit të depozituar në cilësinë e provës pranë Komisionerit, rezulton se marrëdhëniet e punës ndërmjet shoqërisë Albpetrol sh.a dhe ankueses janë rregulluar nëpërmjet kontratës individuale të punës nr. 308/1, datë 23.03.2015. Znj. A. S. rezulton se është anëtare e forcës politike LSI Fier⁵.

1. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueses, lidhur me dhënien e masave disiplinore nga Drejtori i Q.P.N Kuçovë.

Pretendimi i Znj. A. S. për diskriminim i ka fillesat e tij që në vitin 2017, kur ndaj saj janë dhënë 2 (dy) masa disiplinore nga ana e Drejtorit të Q.P.N Kuçovë. Nga provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në referencë të Statutit dhe Rregullores së Brendshme të Albpetrol sh.a. nr. 1357, datë 22.04.2013, Administratorit të Shoqërisë i atribuohet kompetenca për dhënien e masave disiplinore, me propozim të drejtuesit të strukturës përkatëse

⁵ Referuar kartës së anëtarësisë nr. 22870, lëshuar në datën 05.10.2016, nga Lëvizja Socialiste për Integrim;

në varësi të Albpetrol sh.a. Për sa më sipër, Znj. A. S. i është dhënë masë disiplinore “*vërejtje me shkrim*”, nëpërmjet shkresës nr. 89, datë 20.09.2017, të Drejtorit të Q.P.N Kuçovë, për shkak të largimit nga vendi i punës pa lejen e eprorit. Në vijim, nëpërmjet shkresës nr. 101, datë 02.11.2017, të Drejtorit të Q.P.N Kuçovë, ankueses i është dhënë një tjetër masë *disiplinore* “*vërejtje me paralajmërim për zgjidhjen e kontratës së punës*”, me motivacion “*largim nga puna para orarit të mbarimit të punës, si dhe për shkelje të përsëritura*”.

Për sa më sipër, rezulton se masat e sipërpërmendura janë dhënë nga Drejtuesi i Q.P.N Kuçovë, duke u mbështetur në Autorizimin Nr. Extra Prot., datë 05.01.2014, të Administratorit të Albpetrol sh.a., në të cilin citohet: “*Bazuar në Statutin dhe Rregulloren e Brendshme të shoqërisë “Albpetrol sh.a. autorizohen Drejtorët e Qendrave në varësi të shoqërisë Albpetrol sh.a. të japin masa disiplinore ndaj punonjësve në rast të kryerjes së shkeljeve disiplinore, mbështetur në Kontratën Individuale të Punës si dhe në Kodin e Punës*”. Në këtë kontekst, Komisioneri gjykon se Drejtuesi i Q.P.N Kuçovë ka qenë i legjitimuar në të drejtën e tij për dhënie masash disiplinore ndaj punonjësve në varësi të tij, për sa kohë që Administratori e ka autorizuar shprehimisht për të kryer të tilla veprime.

Në formularin e ankesës, Znj. A. S. ka shënuar që çështja e dy masave disiplinore të dhëna në ngarkim të saj, është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor, pasi ajo ka depozituar kërkesëpadi kundër Albpetrol sh.a. Në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Proçedurës Civile parashikohet shprehimisht: “*Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata*”. Në këtë kontekst, vihet re qartë qëndrimi i ligjvënësit, ku juridiksioni gjyqësor prevalon mbi atë administrativ. Në këto kushte, Komisioneri nuk mund të vazhdojë shqyrtimin administrativ të kësaj nën-çështjeje të parashtruar në ankesën e Znj. A. S. dhe nuk mund të shprehet me vendim administrativ, nëse Q.P.N. Kuçovë/Albpetrol sh.a. e ka ekspozuar ankuesen para një trajtimi të padrejtë, disfavorshëm dhe të pabarabartë, për sa kohë që është gjykata që duhet të shprehet së pari, lidhur me ligjshmërinë e masave disiplinore të dhëna nga Drejtori i Q.P.N Kuçovë.

2. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë të ankueses, lidhur me përfshirjen e saj në pushimin kolektiv nga puna, të ndërmarrë në kuadër të zbatimit të ristrukturimit të Albpetrol sh.a.

Referuar dokumentacionit të administruar gjatë proçesit të hetimit administrativ të ankesën nr. 118, datë 09.08.2018, e Znj. A. S. rezulton se mbështetur në Programin e Zhvillimit të Rishikuar për vitin 2018, të miratuar me Vendimin nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës dhe Vendimin nr.496/10, datë 25.06.2018, e Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjisë, Shoqëria Albpetrol sh.a. është duke zbatuar një proçes ristrukturimi, si rrjedhim i së cilit i janë nënshtruar

pushimit kolektiv rreth 450 punonjës, që bëjnë pjesë në administratën e kësaj shoqërie dhe në qendrat e prodhimit e shërbimit në varësi të saj. Nga përmbajtja e akteve të sipërpërmendura rezulton se ky është një proces madhor që po ndodh në këtë shoqëri, si pasojë e ndryshimeve të treguesve kryesore të Programit të Zhvillimit Ekonomik të Shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018. Në nenin 147, pika 1, të Kodit të Punës parashikohet: *“1.Vlerësohet pushim kolektiv nga puna përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëdhënësi, për arsye që nuk kanë të bëjnë me punëmarrësin, kur numri i pushimeve nga puna, brenda 90 ditëve, është, të paktën, 10 punëmarrës për ndërmarrjet me deri në 100 punonjës; 15, për ndërmarrjet me mbi 100 deri në 200 punonjës; dhe 20, për ndërmarrjet me mbi 200 punonjës”*. Numri i punonjësve që i janë nënshtruar pushimit kolektiv pranë Albpetrol sh.a ka qenë rreth 450 të tillë, duke u konsideruar një pushim kolektiv me përmasa të konsiderueshme.

Në pikën 2, të Vendimit nr.496/10, datë 25.06.2018, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë *“Mbi miratimin e ndryshimit të programit të zhvillimit të shoqërisë “Albpetrol” sh.a. për vitin 2018”* parashikohet shprehimisht: *“Miratimin e procesit të ristrukturimit organizativ të njëjësive të Shoqërisë, reduktimit të fuqisë punëtore, strukturës organizative dhe miratimin e numrit total të punonjësve, sipas Vendimit të Këshillit Mbikqyrës nr. 8, datë 07.06.2018, pikat 2,3,4,5,6.”*

Në pikën 2, të Vendimit nr. 8, datë 07.06.2018, të Këshillit Mbikqyrës të Albpetrol sh.a miratohet procesi i ristrukturimit organizativ të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore, si dhe parashikohet përfundimi i këtij procesi brenda datës 01.10.2018. Në pikën 3 të vendimit në fjalë miratohet Struktura Organizative e Shoqërisë “Albpetrol” sh.a.me përbërje 3 (tre) Qendra të Prodhimit të Naftës, 7 (shtatë) Qendra Shërbimi dhe Administrata Qendrore. Në këtë vendim miratohet gjithashtu edhe numri total i punonjësve të Shoqërisë prej 1,828 punonjës, pas përfundimit të procesit të ristrukturimit organizativ, të shpërndarë sipas qendrave.

Në kushtet kur, fuqia punëtore e kësaj shoqërie do të reduktohej me rreth 450 punonjës, si dhe duke patur parasysh faktin se ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a. është lidhur një kontratë kolektive për punonjësit e kësaj shoqërie, në referencë të nenit 148, pika 3, të Kodit të Punës, Albpetrol sh.a. bëri këshillime me organizatën sindikale, e njohur si përfaqësuese e punëmarrësve, me qëllim që të arrihet një marrëveshje. Në këtë kontekst u realizuan takime me sindikatën e sipërpërmendur në mënyrë të të përcaktoheshin kriteret për kryerjen e reduktimit të fuqisë punëtore dhe rregullat e përgjithshme, të cilave do t’u nënshtroheshin punonjësit e kësaj shoqërie të cilët do t’i nënshtroheshin pushimit kolektiv në punë.

Në bazë të marrëveshjes së lidhur ndërmjet Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë (SRNSH) dhe Albpetrol sh.a., kriteret të cilat do të merreshin në konsideratë gjatë procesit të ristrukturimit të shoqërisë dhe reduktimit të fuqisë punëtore ishin: (1) Arsimi, (2) Kualifikimi profesional/kategoria/patent specifike dhe (3) vjetërsia në punë në industrinë e naftës. Përzgjedhja e punonjësve sipas kriterëve të përcaktuara më sipër do të kryhej sipas vlerësimit me pikë të përcaktuar në këtë marrëveshje. Sipas shpjegimeve të dhëna nga strukturat e Albpetrol sh.a., vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit do t'i nënshtroheshin vetëm ata punonjës, të cilët kishin pozicione të njëjta punë, ndërkohë që nga këto pozicione, disa prej tyre suprimoheshin. Punonjësit që kishin pozicion pune unik ose të vetëm dhe ky pozicion shkërtohej, nuk i nënshtroheshin vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit.

Në vijim, Albpetrol sh.a. miratoi aktet nënligjore, nëpërmjet së cilave përcaktoi rregullat e hollësishtme, lidhur me mënyrën se si do të kryhej ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore. Aktet përkatëse konsistojnë në Urdhërin nr. 49, datë 02.07.2018, e Administratorit për fillimin e procesit të ristrukturimit organizativ dhe reduktimin e fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.; Urdhërin nr. 50, datë 02.07.2018, e Administratorit për ngritjen e Komisioneve dhe kryerjen e procesit të ristrukturimit, si dhe Shtojcën nr.1 e cila është pjesë integrale e këtij urdhëri; Urdhërin nr.51, datë 02.07.2018, të Administratorit për përcaktimin e përfaqësuesve të administratës që do të jenë pjesë e komisioneve në Qendrat e Prodhimit dhe Shërbimit, si dhe Urdhërin nr. 63, datë 16.07.2018, të Administratorit të Albpetrol sh.a., lidhur me procedurën e kontrollit dhe Administrimit të procesit të ankimimeve të punonjësve që preken nga ristrukturimi dhe reduktimi i fuqisë punëtore të Albpetrol sh.a.

Në referencë të Akt-Marrëveshjes me Sindikatën e Naftëtarëve, Albpetrol sh.a. iu drejtua të gjithë qendrave në varësi të tij, me shkresën nr. 5537, datë 02.07.2018, nëpërmjet së cilës i njoftonte në lidhje me përfaqësuesit e Sindikatës së Re të Naftëtarëve Shqiptarë, që do të ishin pjesë e komisioneve të vlerësimit të ngritura në çdo qendër.

Në referencë të Vendimit nr.14, datë 29.08.2018, të Këshillit Mbikqyrës së Albpetrol sh.a., “*Mbi programin e zhvillimit ekonomik të rishikuar për vitin 2018*”, numri i përgjithshëm i punonjësve të Qendrës së Prodhimit të Naftës Kuçovë, pas kryerjes së ristrukturimit të shoqërisë është reduktuar, në krahasim me numrin e mëparshëm të punonjësve pranë kësaj qendre. Në zbatim të nenit 147, pika 5, të Kodit të Punës, 27 punonjës të Qendrës së Prodhimit të Naftës Kuçovë janë njoftuar për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, si pasojë e pushimit kolektiv. Znj. A. S. punonte në pozicionin e punës “*jurist*” pranë kësaj Qendre, pozicioni i cili është shkërtuar.

Me anë të shkresës nr. 6508, datë 24.07.2018, Albpetrol sh.a. e ka njoftuar Znj. A. S., lidhur me ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të pushimit kolektiv. Në vijim, Znj. A. S. ka dërguar ankimin e saj nr. 6865, datë 30.07.2018, drejtuar Administratorit të Shoqërisë, ku shprehet se e konsideron të padrejtë ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me këtë Shoqëri. Në përgjigje të ankesës së Znj. A. S., Albpetrol sh.a dërgoi shkresën nr.6865, datë 11.09.2018, nëpërmjet së cilës ankuesja sqarohet lidhur me faktin se, ajo i është nënshtruar pushimit kolektiv nga puna për shkak të ristrukturimit të shoqërisë, pasi pozicioni i saj i punës është shkurtuar. Referuar shkresës nr. 6508, datë 24.07.2018, Albpetrol sh.a., marrëdhëniet e punës së ankueses me Albpetrol sh.a. janë zgjidhur në përfundim të afatit të njoftimit, në datën 28.09.2018.

Sikurse u përmend edhe më sipër, rezulton se 27 punonjës pranë Q.P.N. Kuçovë i janë nënshtruar pushimit kolektiv nga puna, ndër të cilët edhe Znj. A. S.. Pozicioni i punës së Znj. A. S. është suprimuar dhe në kushtet, kur ky pozicion pune ka qenë i vetëm, Znj. A. S. nuk i është nënshtruar vlerësimit nëpërmjet sistemit të pikëzimit. Në referencë të shkresës nr. 5537, datë 02.07.2018, së Albpetrol sh.a., rezulton se në çdo Komision Vlerësimi të ngritur pranë çdo qendre prodhimi apo shërbimi, në varësi të Albpetrol sh.a., bën pjesë në cilësinë e anëtarit edhe një përfaqësues i Sindikatës së Naftëtarëve, e cila është përfaqësuese e punonjësve të Albpetrol sh.a. Kjo shërben si një garanci për të gjitha veprimet e kryera nga Komisionet përkatëse, pasi përfaqësuesit e Sindikatës mbrojnë interesat e punonjësve të Albpetrol sh.a. Ankesa e Znj. A. S. drejtohet kundër Q.P.N. Kuçovë, ndërkohë që punëdhënësi i saj është Albpetrol sh.a dhe procesi i ristrukturimit dhe pushimit kolektiv të punonjësve të qendrave të prodhimit apo shërbimit kryhet nga Administratori dhe strukturat përgjegjëse në administratën qendrore të tij.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri gjykon se Q.P.N. Kuçovë/Albpetrol sh.a. nuk ka ndërmarrë veprime që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj ankueses, ose që e kanë ekspozuar atë, ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, në krahasim me persona të tjerë, që ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme me të.

Në mungesë të trajtimit të padrejtë, disfavorizues e të pabarabartë, Komisioneri gjykon se nuk kemi të bëjmë me diskriminim për shkakun e pretenduar nga ankuesja.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 18 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 9, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), nenin 1, nenin 7, pika 1, nenet 11-13, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a) e nenin 33, pikat 10-11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit, për shkak të “bindjes politike”, të Znj. A. S., nga ana e Q.P.N. Kuçovë/Albpetrol sh.a.
2. Kundër këtij Vendimi lejohet ankim, brenda afateve ligjore, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Robert GAJDA

KOMISIONERI

(Shkak – bindjet politike
Fusha – Punësim)